Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0874

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Wire Labs Kosova" L.L.C., dhe OE "Cacttus" Sh.a., kundër vendimit për dhënie të një kontratë, "Ministria e Ekonomisë" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Implementimi i rrjetit të pavarur jopublik 5G në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren" me numër të prokurimit 213-23-7161-1-1-1, me 11/01/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohen**, si të bazuara ankesat e OE "Wire Labs Kosova" L.L.C., me nr. 2023/0870, e datës 06/11/2023, si dhe OE "Cacttus" Sh.a., me nr.2023/0874 e datës 06/11/2023 kurse vendimi i AK "Ministria e Ekonomisë", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Implementimi i rrjetit të pavarur jopublik 5G në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren" me numër të prokurimit 213-23-7161-1-1-1anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Wire Labs Kosova" L.L.C., dhe "Cacttus" Sh.a.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.07.2023, "Ministria e Ekonomisë" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Implementimi i rrjetit të pavarur jopublik 5G në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren" me numër të prokurimit 213-23-7161-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratëspër furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 1,600,000.00 €.

Me 10.10.2023 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë GOE "3 CIS JSC & Inter Adria L.L.C" .

Me 24.10.2023, OE "Wire Labs Kosova" L.L.C., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Me datë 24.10.2023 po ashtu edhe OE "Cacttus" Sh.a., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 26.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara ankesat e të dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues .

Me 06/11/2023, OE "Wire Labs Kosova" L.L.C., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 870/23 ndërsa me datë 06/11/2023 OE "Cacttus" Sh.a., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 874/23.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 870/23 dhe ankesa nr. 874/23 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues"Wire Labs Kosova" L.L.C., janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi *: "Autoriteti kontraktues ne rastin e shpalljes se vendimit për dhënie te kontratës ka bere shkelje të neneve Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Neni 64 Dëshmitë e Kërkesave Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale. 1. Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesën e dosjes se tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 ku kërkohet: operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses*

kontratat për implementimin e Rrjetit Jopublik 5G (Rrjeti Privat) në vlerë minimale prej 2,000,000.00 (dy milionë) Euro dhe dëshmia e kërkuar dokumentare : Lista e kontratave të përfunduara, e cila plotëson të Dosjes së Tenderit, ku emri i kontratës, shuma e kontratës, data e fillimit dhe përfundimit dhe përfituesi, si dhe referencat apo certifikatat për kryerjen e punët dhe shërbimet duhet ti bashkëngjiten listës. OE ne këtë rast ka ofruar një liste me Purchase order (PO) ku tregohen shërbimet e dhëna me stafi lokal ne Kosovë për klientët e CISCO neper bote, gjë qe vërteton se nuk ka as një projekt te implemntuar për projekt 5G PRIVATE (jo publike) rrjedhimisht nuk plotësojnë kërkesat e dosjes se tenderit ku duhet këtë përfunduar kontrate për implementim te rrjetit 5G(Rrjeti privat) dhe janë te papërgjegjshëm , gjithashtu edhe Referenca e lëshuar nga CISCO nuk përmbush kërkesat e dosjes se tenderit ku duhet te këtë emrin i kontratës, shuma e kontratës, data e fillimit dhe përfundimit te projektit ne këtë rast projekt 5G private, gjithashtu referenca e Cisco vërteton faktin se kompania 3CIS nuk ka implementuar as një projekt te natyrës se kërkuar por ka kryer shërbime tjera profesionale."

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, OE "Wire Labs Kosova" L.L.C., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59, 64, 69 të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP qe te aprovoje ankesën tone dhe lenden te kthej ne rivlerësim.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE "Wire Labs Kosova" L.L.C., " *Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 26.10.2023, AK ka dhënë arsyetimin si vijon: "Ne përgjigje te kërkesës suaj për rishqyrtim sipas Nenit 108A te Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik te Republikës se Kosovës, ju njoftojmë se Autoriteti Kontraktues pretendimin për liste te kontratave dhe referenca. -Konstatimi i shkeljes se nenit 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Vlerësimi i ofertave është bere ne harmoni me neni 59 është kontrolluar dhe është verifikuar. aq sa kemi pas kapacitete ligjore. Konstatimi eshët i pa baze. -Konstatimi i shkeljes se Neni 64 Dëshmitë e kërkesave. A.K. qe do te thotë komisioni vlerësues ka zbatuar neni 64 me përpikëri dhe vlerësimi ofertave është bere sipas kërkesës se komisionit të vlerësimit ne kemi bere kërkesë për dokument shtesë sipas nenit 72 të LPP-së dhe 10.1 .dhe të Udhëzues Nr-001_2023 për prokurimin publik për listën e kontratave dhe brenda afatit kemi pranuar dokumentin ose dëshminë që do të thotë nuk është bere shkelje e nenit 64 .Konstatimi është i pa baze. -Konstatimi i shkeljes se nenit 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale A.K. qe do të thotë komisioni vlerësues ka zbatuar neni 69 me përpikëri. Komisioni i vlerësimit qe ka qene profesional, përbërja ka qene 2 vendor dhe një ndërkombëtar. Gjate vlerësimit të ofertave, në ofertën e O.E. të shpërblyer ka konstatuar se referenca është ne të oferte por nuk është lista e kontratës duke u mbështet ne nenin 59.2 dhe 72 te LPP-se dhe nenin 10.1 te udhëzuesi Nr-001_2023 për prokurimin publik citat: Lista e kontratave te Mund te kërkohen 69 realizuara nuk është informata sqaruese dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca / certifikata e pranimit / kontrata) A.K. ka vepruar sipas neneve te cekura me lart dhe i kemi pranuar ne afat ligjor dhe atë: -Pagesat nga viti 2017 e deri me 2023,kontraten ne mes te palëve CISCO dhe 3 CIS JSC qe është vlerësuar nga komisioni qe është plotësuar kërkesa sipas nenit 69 te LPP-se. Dokumente e tilla komisioni i vlerësimit te ofertave nga ana e Autoritetit Kontraktues i ka cilësuar si prova te bazuara dhe dëshmi për kryerje te projekteve me sukses për implementimin e Rrjetit Jopublik SG (Rrjeti Privat) dhe e ka cilësuar OE "3CIS & lnteradria" te*

përgjegjshëm nga ana e Kapaciteti teknik dhe profesional. Konstatimi është i pa baze."

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues"Cacttus" Sh.a., janë parashtruar si në vijim:

Operatori ekonomik thekson se "*Më datën 19.10.2023, Autoriteti Kontraktues – Ministria e Ekonomisë në Platformën e E-prokurimit ka bere publikimin e Formularit B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ku për aktivitetin me numër të prokurimit: 213-23-7161-1-1-1 - Implementimi i Rrjetit të pavarur jo publik 5G në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren. Këtij vendimi AK, ja ka bashkangjitur edhe Letrat Standarde për Tenderuesin e Suksesshëm, Tenderuesit e Pa suksesshëm dhe Tenderuesin e Eliminuar. Pasi kemi analizuar ketë vendim, kemi vërejtur së Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar që me kontrate të shpërblehet Grupi i OE: " 3 CIS JSC ; Inter Adria L.L.C., nga Prishtina, menjëherë me datën 19.10.2023 kemi dërguar të Autoriteti Kontraktues kërkesën për qasje në dokumentet e tenderit. Të njëjtën kërkesë për qasje ne dokumentet e tenderit e kemi përsëritur edhe me datën 20.10.2023. Nga Autoriteti Kontraktues qasja ne dokumentet e tenderit na është lejuar tek me datën 23.10.2023 ne ora 10:00, një dite para afatit të fundit për dërgim të Kërkesës për Rishqyrtim të AK. Me datën 23.10.2023 ne ora 10:00 kemi shkuar në zyrën e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit të AK, ku na ka lejuar vetëm qasje të kufizuar në dokumentet e tenderit të Grupit të OE: " 3 CIS JSC ; Inter Adria L.L.C., nga Prishtina, që është renditur ne vendin e pare me 77.70 pikë dhe Grupit të OE: Wire Labs Kosova L.L.C.; A &B engineering SH.P.K.; WIDELITY L.LC; Wireless laboratories INC, që është rendit ne vendin e dyte me 67.35 pikë. Nga dokumentet që kemi pasur qasje kemi konstatuar së ofertat e këtyre dy grupeve të Operatoreve Ekonomik janë oferta të pa përgjegjshme pasi që nuk i kane plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues të shënuar në Dosje të Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë. Më datën 24.10.2023, përmes platformës së E-Prokurimit, kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues- Ministria e Ekonomisë. Në Kërkesën për Rishqyrtim të cilën e kemi dërguar të AK me datën 24.10.2023, në mënyre të detajuar kemi shënuar të gjitha pretendimet tona ankimore për të cilat kemi konsideruar së AK i ka bere gjatë vlerësimit të ofertave. Më datën 26.10.2023 nga Autoriteti Kontraktues kemi pranuar Vendimin për refuzimin si të pa bazuar të Kërkesës tone për Rishqyrtim."*

Pretendimet tona ankimore lidhur me ofertën e Grupit të OE: 3 CIS JSC & InterAdria L.L.C. nga Prishtina:

Pretendimi : *"Referencat Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 , pika 1, ka kërkuar: 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për implementimin e Rrjetit Jopublik 5G (Rrjeti Privat) në vlerë minimale prej 2,000,000.00 (dy milionë) Euro. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Një listë e kontratave të përfunduara, duke plotësuar të Dosjes së Tenderit ku duhet të specifikohen titulli i kontratës, shuma e kontratës, data e fillimit dhe data e përfundimit dhe përfituesi, si dhe referencat ose certifikatat për Kryerja e punëve dhe shërbimeve duhet ti bashkëngjitet listës. Për ta plotësuar ketë kërkesë të AK, Grupi i OE: " 3 CIS JSC ; Inter Adria L.L.C. nga Prishtina së bashku me ofertën ka dorëzuar vetëm*

këto dëshmi: 1. Referencën e lëshuar nga CISCO të datës 14.08.2023 për kompaninë 3CIS J.S.C 2. Një katalog të referencave private të muajt Prill 2023 të kompanisë NOKIA. Duke ju referuar Nenit 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale dhe kërkesës ne Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 , pika 1, shihet së Grupi i OE: " 3 CIS JSC ; Inter Adria L.L.C. nga Prishtina, nuk ka dëshmuar që ka përkundur kontrate për implementim të rrjetit jo publik 5G në vlere minimale prej 2 milion €. · Grupi i Operatorit Ekonomik "3CIS JSC & InterAdria L.L.C" në ofertën e tyre në tender ka dorëzuar një Letër Reference e përgjithshme të lëshuar nga një përfaqësues nga ana e CISCO i cili rekomandim nuk ka ndonjë përshkrim konkret mbi shërbimet, produktet dhe vlera. - Letër referenca përshkruan një rekomandim për kompaninë 3CIS JSC si partner i preferuar i Cisco në ofrimin e shërbimeve të jashtëzakonshme profesionale për Cisco për zbatimin e Rrjetit 5G publikut dhe jopublik në një periudhë kohore prej gjashtë viteve, me shërbime të ofruara prej 1 milionë USD në vit. Letër referenca nuk ka të dhëna specifike konkrete për projektet, klientët, cilësinë të angazhimit në projekte, etj. Dëshmia 1- Letër Reference e datës 14.08.2023; · Grupi i Operatorit Ekonomik "3CIS JSC & InterAdria L.L.C" ka ofruar si dëshmi po ashtu Listën e referencave të cilat NOKIA ka implementuar suksesshëm projekte të rrjeteve 5G në mbarë botën, përkundër qe NOKIA nuk është amtare e Konzorciumit. Lista e Referencave e dorëzuara të operatorit ekonomik NOKIA e cila në këtë rast nuk është fare pjese e konzorciumit , për Grupin e Operatorëve Ekonomik 3 CIS JSC & InterAdria L.L.C , nuk mund të merren parasysh në këtë aktivitet te prokurimit. Dëshmia 2- Nokia Private Wireless Public Customer Reference Presentation.

Pasi që Grupi i OE: " 3 CIS JSC ; Inter Adria L.L.C. nga Prishtina së bashku me ofertën nuk e ka dorëzuar Listën e Kontratave ashtu siç ka qene kërkesa ne Dosje të Tenderit dhe Njoftimit për Kontrate, Autoriteti Kontraktues gjate vlerësimit të ofertave me datën 30.09.2023 ka dërguar të ky grup i OE, Letrën Standarde –Kërkesë për sqarimin e tenderit ku shënon: "Listën e kontratës nuk e keni sipas kërkesës dhe dëshmis se kërkuar por keni një reference (pa shume totale por vetëm përafrisht një milion dollar për vite), për një kontrate nëse posedoni na e dërgoni me date të theksuar para dorëzimit të ofertave. Ju e keni dorëzuar referencën, por ne kërkoj listën e kontratës e cila e specifikon se cilat shërbime i keni kryer ne kuadër të kontratës , kërkesa behet sipas nenit 72 te LPP-së. Operator te nderuar informatat ti dërgoni përmes sistemit te e-prokurimit deri me datën 04.10.2023, ne të kundërtën oferta e juaj refuzohet"- Dëshmia 3 - Letra Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit e datës 30.09.2023 Grupi i OE: " 3 CIS JSC ; InterAdria L.L.C. nga Prishtina, me datën 04.10.2023 për mes Platformës se E-Prokurimit ka dërguar sqarimet të AK- Ministria e Ekonomisë këto dokumente: 1. Deklarate për sqarime shtese 04.10.2023 2. Informata sqaruese InterAdria 04.10.2023. Dokumentacioni i dorëzuar nga ana e Grupi i Operatorit Ekonomik "3CIS JSC & InterAdria L.L.C" janë kryesisht Urdhër Blerje të lëshuara nga CISCO Systems për kompaninë 3CIS JSC si dhe Fatura të lëshuara nga ana e kompanisë 3CIS JSC ndaj CISCO Systems me përshkrime për kryerje E këtyre shërbimeve: - Multi Project Support Services - SP Professional Service. Gjithashtu dokumentacioni i dorëzuar me sqarimet e datës 04.10.2023 përmban një marrëveshje si vijon: Cisco Services Subcontractor Statement of Work (SOW), i nënshkruar nga kompania 3CIS JSC dhe CISCO Systems i cili ka të

bëjë me ofrimin e shërbimeve konsulentë të parapara të ofrohen në distance (Remote) për një kohë të caktuar jo me tepër se 12 muaj pas nënshkrimit të SOW dhe datës të fillimit T(0) të caktuar nga ana e CISCO Systems me lëshimin e Urdhër blerjes (SO). Shërbimet e dakorduara në SOW janë shërbime në distance të specifikuara Consulting Engineer 4 lidhur me Multi Project Support Services pa data, numrin e konsulentëve dhe vlerë të Kontratës (është caktuar vlera në USD për një ditë pune të konsulentit) dhe pa asnjë dëshmi për implementim dhe kryerje të projekteve me sukses për implementimin e Rrjetit Jopublik 5G (Rrjeti Privat). Gjithashtu ky grup i OE ka dërguar një tabele të përgatitur ne Excel të faturave e cila nuk i ka të shënuara të dhënat të cilat i ka kërkuar AK ne Letrën Standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit të datës 30.09.2023, siç është lista e kontratave e cila e specifikon së cilat shërbime janë kryer ne kuadër të kontratës që ka të beje me referencën e lëshuar nga CISCO me datën 14.08.2023. Lista të cilën ky grup i OE i ka dorëzuar se bashku me sqarimet e datës 04.10.2023 nuk ka të shënuar ne asnjë rubrike se cilat kane qene shërbimet të cilat i ka kryer kompania "3 CIS JSC" gjate tri viteve të fundit dhe kjo nuk është një liste e kontratave por është një liste e faturave për të cilat nuk ka asnjë dëshmi se për cilat shërbime janë faturuar . Ne ketë liste të faturave ka të shënuara edhe fatura që janë faturuar pas datës së publikimit të Njoftimit për Kontrate dhe pas datës së hapjes se ofertave të këtij aktiviteti të prokurimit që ka qene data 21.08.2023. Gjithashtu kjo liste nuk ka të shënuar emrin e Operatorit Ekonomik dhe nuk dihet së kush e ka hartuar dhe të dhënat e cilës kompani janë të shënuara në ketë liste. Gjithashtu kjo Liste nuk ka të shënuar asnjë emër te përfaqësuesit të Grupit të OE dhe nuk është e nënshkruar nga asnjë person i autorizuar nga grupi i OE: " 3 CIS JSC ; InterAdria L.L.C. Duhet theksuar së ky Grup i OE nuk e ka dërguar kontratën në mes të CISCO dhe kompanisë "3 CIS JSC" , ashtu siç e ka kërkuar Autoriteti Kontraktues ne Letrën Standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit të datës 30.09.2023. Të gjitha këto fakte që i cekem me larte dëshmojnë së Grupi i OE: " 3 CIS JSC; Inter Adria L.L.C. nga Prishtina, as për së afërmi nuk e plotëson kërkesën mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 , pika 1, ku saktësisht është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues qe Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për implementimin e Rrjetit Jopublik 5G (Rrjeti Privat) në vlerë minimale prej 2,000,000.00 (dy milionë) Euro."

Pretendimi : *Zgjidhja Teknike e ofruar Grupi i Operatorit Ekonomik "3CIS JSC & InterAdria L.L.C" në ofertën e tyre në tender ka dorëzuar zgjidhjen teknike si në vijim: Nokia DAC Solution: Zgjidhja e ofruar nga OE "3CIS & Interadria" është Nokia DAC (Digital Automation Cloud) e cila kërkon një menaxhim "Cloud Management" për sistemin e ofruar, që do të thotë se duhet ta keni rrjetin privat gjithmonë të lidhur me internetin dhe shërbimin Cloud të Nokis, i cili në këtë rast paraqet një çështje sigurie. Me këtë opcion të ofruar "Cloud Management" zgjidhja e OE "3CIS&Interadria": • Nuk është 100% një Rrjet Privat plotësisht "on premisës", i lokalizuar në ambientet e Autoritetit Kontraktor; • Cloud Management i ofruar është dhënë me modalitetin e Licensimit me abonim; • Duke patur parasysh faktin e kostos së licencës - pasi që sistemi të jetë konfiguruar dhe për të funksionuar, sistemi duhet të paguajë gjithmonë tarifën mujore të abonimit për licencat. • Licencat e ofruara janë licenca të bazuar me abonim dhe janë valide për një periudhë 4 vjeçare (48 muaj). • Pas përfundimit të periudhës 4 vjeçare të*

validitetit të licencave, Autoriteti Kontraktues nuk mund te operoje me ketë sistem nëse nuk vazhdon me pagese mujore të licencave. • Me ketë Autoriteti Kontraktues është i obliguar për të nënshkruar kontrata të vazhdueshme për abonim të licencave të Nokia në mënyrë që të vazhdojë të funksionojë sistemi.

• Kjo paraqet kundërshtim me kërkesën me Annex 1.Specifikacioni Teknik i Obligueshëm të kërkesës në dosjen e tenderit. RAN Solution: · Zgjidhja e OE "3CIS&Interadria" me numrin e antenave dhe konfigurimin e dhënë nuk është e mundur të arrihet që xhiroja minimal i rrjetit (sistemi) DL të jetë 6 Gbps dhe xhiroja minimale e rrjetit (sistemi) UL të jetë 3 Gbps. · Mbulimi i tërë zonës me katër antena në një shtyllë nuk është i mundur të plotëson kërkesën obligative te cekur në Annex 1. Specifikacioni Teknik I Obligueshëm të kërkesës në dosjen e tenderit: Minimumi SS-RSRP i kërkuar është >= -90dBm. SS-RSRQ kërkohet >= -15 Db · - Planifikimi i brendshëm dhe i jashtëm me këtë radio planifikim nuk mund të plotëson kërkesën minimale SS-RSRP prej >= - 90 dbm. - 300 përdorues të njëkohshëm nuk janë të mundur vetëm me një antenë të brendshme të paraparë në zgjidhjen teknike për Ndërtesën A të ofertuar nga OE "3CIS&;Interadria". Një radio e brendshme për 300 përdorues në të njëjtën kohë do të mbingarkojë këtë RU të brendshme. Me vetëm 7 radio me QAM64 dhe 20 MHz nuk është e mundur të arrihet xhiroja minimale e rrjetit (sistemi) UL të jetë 3 Gbps. · Planifikimi i radios (hartë nxehtësie "heat map") për ambiente të jashtme nuk është paraqitur në zgjidhjen e ofruar nga OE "3CIS&;Interadria". · Hartët nxehtësie "heat maps" të prezantuara për hapësirat e brendshme pa ndonjë legjendë të përshkrimit të ngjyrave të paraqitura nuk siguron ndonjë kuptim që sistemi i ofruar i plotëson kriteret e kërkuara."

Pretendimi : *"Funksionale dhe kërkesat e cilësisë sipas specifikacionit teknik · Grupi i OE: "3CIS & Interadria" ne ofertën e tyre nuk e ka plotësuar Tabelën 6 e cila ka qenë kërkesë obligative. · Sipas specifikacionit teknik, pika 3.1.2.2 - Kërkesat për infrastrukturën e virtualizimit dhe nivelet e menaxhimit, tabela e kërkuar të plotësohet është: · Tabela 6: Kërkesat për infrastrukturën e virtualizimit dhe nivelet e menaxhimit , në të cilën tabelë, përpos tjerash, janë disa kërkesa të klasifikuara nga AK ne kategori specifika MANDATORE te cilat duhet të përmbushen nga OE, të cilat janë të specifikuara në tabele si vijon: Kërkesat Funksionale: - Kërkesa 2.9 dhe 2.10 · Kërkesat e Cilësisë: - Kërkesa 2.13 dhe 2.14 Më poshtë janë pikat të shkëputura të kërkesave Mandatorë të specifikuara në tabelë 6: Grupi i OE "3CIS &InterAdria", fare nuk e ka plotësuar Tabelën 6, dhe nuk është përgjigjur në kërkesat Mandatorë të Autoriteti Kontraktues te kërkuara ane Aneksin nr. 1 të Dosjes se Tenderit. Përkundër të gjitha këtyre lëshimeve dhe mangësive ne ofertën e tyre, Grupi i OE "3CIS & Interadria" , nga Autoriteti Kontraktues klasifikohet si i përgjegjshëm teknikisht dhe AK e ka rekomanduar qe te shpërblehet me kontrate. Të gjitha këto fakte i kemi cekur edhe ne Kërkesën tone për Rishqyrtim të datës 24.10.2023 por fatkeqësisht Autoriteti Kontraktues i neglizhojë dhe nuk i morri për baze këto fakte duke marre vendimin që Kërkesën tone për Rishqyrtim ta konsideroj si të pa bazuar ku ne vendimin me nr. protokolli 3991 të datës 26.10.2023 konstatimin tonë e klasifikon së konstatimi jone është i pa bazë dhe arsyeton se OE "3CIS &; InterAdria" të përgjegjshëm: Po e citojmë: Në përmbledhje, oferta paraqet pika të forta sa i përket një zgjidhjeje me një shitës të vetëm me përvojë si Nokia dhe planifikimin e detajuar të rrjetit-*

Dëshmia 4. : Vendim i refuzimin të kërkesës për rishqyrtim i datës 26.10.2023.

Pretendimet tona ankimore lidhur me ofertën e Grupit të OE: "Wire Labs Kosova; A&B engineering; WIDELITY L.L.C; Wireless Laboratories INC " Kërkesa për rishqyrtim nga Grupi i operatorëve ekonomik Cacttus Sh.a. & COCUS AG e dorëzuar me datë 24 tetor 2023 ishte bazuar në faktet të cilat vërtetojnë se Grupi i Operatorit Ekonomik "Wire Labs Kosova; A&;B engineering; WIDELITY L.L.C; Wireless Laboratories INC" nuk i ka përmbushur kriteret e përshtatshmërisë teknike dhe profesionale në këtë pike. Pretendimi 1: Referencat · Grupi i Operatorit Ekonomik "Wire Labs Kosova; A&;B engineering; WIDELITY L.L.C; Wireless Laboratories INC" në ofertën e tyre në tender ka dorëzuar Referencën e AT&T Mobility Labs lëshuar për Wireless Laboratories Inc por nuk e ka dorëzuar edhe Listën e Kontratave te realizuar ashtu siç e ka kërkuar AK ne Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate. Dokumenti është një Letër rekomandimi lëshuar për kompaninë Wireless Laboratories Inc. në të cilin ceket që Wireless Laboratories Inc. ka ofruar shërbime profesionale dhe implementim të projekteve në vlerë të përgjithshme 5 milion USD në 3 vitet e fundit, projekte të cilat përfshijnë edhe Instalime Laboratorike (Lab set ups). Në dokument rekomandimi nuk ka të dhëna për projekte dhe Kontrata të përfunduara për implementimin e Rrjetit Jopublik 5G (Rjeti Privat). Nuk ka të dhëna për projekte, klientët, në cilësi të angazhimit në projekt si janë kërkuar në tender: emri i kontratës, shuma e kontratës, data e fillimit dhe përfundimit dhe përfituesin. Përkundër në mungesë të dëshmive dhe të dhëna për projekte dhe Kontrata të përfunduara për implementimin e Rrjetit Jopublik 5G (Rjeti Privat), AK konstaton se OE mund të jetë i përgjegjshëm, nuk e eliminon nga gara dhe e renditë me pike me numër rendor 2. Pretendimi 2: Zgjidhja teknike konform kërkesave te dosjes te tenderit Gjatë takimit me AK me date 23.10.2023 dhe qasjes të lejuar në ofertën teknike të Grupit te Operatorit Ekonomik "Wire Labs Kosova; A&;B engineering; WIDELITY L.L.C; Wireless Laboratories INC, kemi vërejtur se në ofertën e dorëzuar nuk ka prezantuar zgjidhjen lidhur me Mbështetje për Rastet e Përdorimit si dhe nuk ka prezantuar të dhëna, broshura apo specifikacione teknike për ndonjë pajisje lidhur me këtë Me kërkesën tonë me email të datës 01.11. 2023 drejtuar AK, me date 02. 11. 2023 na është dërguar me email Raporti i Vlerësimit të Tenderëve nga i cili shkëpusim Deklaratën e komisionit të vlerësimit të ofertave në të cilin pohon se për Mbështetjen për Rastet e Përdorimit një mangësi e dukshme për rastet e propozuara të përdorimit. Përmendja paksa e mjegullt e mbështetjes ngre shqetësime në lidhje me angazhimin dhe aftësinë e shitësit për të përmbushur kërkesat specifike të rasteve të përdorimit. Përkundër së Grupi i Operatorit Ekonomik "Wire Labs Kosova; A&;B engineering; WIDELITY L.L.C; Wireless Laboratories INC, nuk ka prezantuar zgjidhjen lidhur me Mbështetje për Rastet e Përdorimit si dhe nuk ka prezantuar të dhëna, broshura apo specifikacione teknike për ndonjë pajisje lidhur me këtë dhe më tepër ka pasur shqetësime dhe dilema në lidhje me angazhimin dhe aftësinë e shitësit për të përmbushur kërkesat specifike të rasteve të përdorimit AK nuk e eliminon nga gara dhe e renditë me pike me numër rendor 2. Bazuar ne Raportin e Vlerësimit të ofertave të datës 11.10.2023 dhe të aprovuar nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me datën 17.10.2023 shihet se Raporti i Vlerësimit të ofertave është i nënshkruar nga vetëm dy anëtaret e komisionit të vlerësimit të ofertave. Anëtari ndërkombëtar i vlerësimit të ofertave z. Pierre Kehl, fare nuk e ka nënshkruar raportin e vlerësimit. Aprovimi i

Raportit te vlerësimit të ofertave nga ana e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit pa nënshkrim e të gjithë anëtareve të komisionit të vlerësimit është shkelje substanciale e legjislacionit të prokurimit publik të aplikueshëm në republikën e Kosovës. Dëshmia 5: Raporti i Vlerësimit të ofertave i datës 11.10.2023; Nga faktet e shpalosura me larte në këtë ankese, shihet së Autoriteti Kontraktues – Ministria e Ekonomisë gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit, ka bere shkelje substanciale të nenit 7, 59 dhe 60 dhe 69 të Ligjit të Prokurimit Publik, Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05//L-092."

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi "Cacttus" Sh.a., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05//L-092. Shkeljet e dispozitave të LPP Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që Ankesa jonë të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe lënda të kthehet ne rivlerësim.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE "Cacttus" Sh.a., *"Në përgjigje të kërkesës suaj për rishqyrtim sipas Nenit 108A të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, ju njoftojmë se Autoriteti Kontraktues pretendimin për listë të kontratave dhe referenca. -Konstatimi i shkeljes se nenit 7. Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi. Nuk qëndron sepse te gjithë operatoret janë trajtuar ne mënyrë te barabartë nga komisioni dhe janë poentuar me pike sipas prezantimit te kërkesave te dorëzuar ne ofertën. Konstatimi është i pa baze.*

-Konstatimi i shkeljes se nenit 28 Specifikimet teknike Operator i nderuar ju informoj se komisioni ka qene profesional dhe unë sa përket specifikacionit teknik kane qene njëzëri për tre oferta kane qene ne harmoni me Ligjin ne fuqi, ju e vërtet keni pas qasje me datën 23.102023 ku e keni pasë qasje të pa kufizuar, edhe keni konstatuar se nuk i plotëson kushte për shpërblim me kontratë, por unë i besoj komisionit të vlerësimit dhe mbetem pas rekomandimit te tyre. Komisioni ka vlerësuar se oferta është teknikisht e realizueshme sipas kërkesave në tender, që zgjidhja e propozuar është teknikisht e shëndoshë dhe se përmbushë kërkesat e specifikuara. Kjo është thelbësore pasi hedh themelet për një rrjetë të suksesshme.

Zgjidhja me një Shitës (ang. vendor): Një përparësi e kësaj oferte është se të gjitha pajisjet vijnë nga një shitës i vetëm me përvojë të gjerë, Nokia. Përdorimi i një zgjidhjeje me një shitës të vetëm mund të thjeshtojë integrimin e rrjetit dhe të zvogëlojë problemet e përputhshmërisë, pasi të gjithë komponentët janë projektuar për të punuar pa probleme së bashku. Përvoja e Nokia-s në këtë industri rrit më tej besimin në besueshmërinë dhe performancën e pajisjeve. Planifikimi i detajuar i rrjetit: Planifikimi i detajuar i ofertës për aspektet e rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm është një aspekt pozitiv për tu lavdëruar. Planifikimi i detajuar është thelbësor për optimizmin e mbulueshmërisë, kapacitetit dhe performancës së rrjetit, duke siguruar që zgjidhja

mund të plotësojë kërkesat e specifikuara dhe të ofrojë një shërbim me cilësi të lartë. Në përmbledhje, oferta paraqet pika të forta për sa i përket një zgjidhjeje me një shitës të vetëm me përvojë si Nokia dhe planifikimin e detajuar të rrjetit Konstatimi është i pa baze. -Konstatimi i shkeljes se nenit 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Vlerësimi i ofertave është bere ne harmoni me neni 59 është kontrolluar dhe është verifikuar aq sa keni pas kapacitete ligjore. Konstatimi është i pa baze. -Konstatimi i shkeljes se nenit 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës. A.K. qe do te thotë komisioni vlerësues ka zbatuar neni 60 me përpikëri dhe vlerësimi i ofertave është bere sipas kriterit ekonomikisht më te favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit dhe atë: Ju jeni shpërblye me poenë ne nen kriterin e çmimit 36.39 pike, kriteri" Kërkesat Funksionale dhe Kërkesat e Cilësisë sipas specifikacionit teknik", më 24.31 pike dhe kriteri Qëndrueshmëria (afati i mirëmbajtjes min. 3 deri ne max 7 vjet nga implementuesi), me 2.14 pike. Poentimi është bere proporcionalisht me formulë. Konstatimi është i pa baze. -Konstatimi i shkeljes se nenit 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale A.K. që do te thotë komisioni vlerësues ka zbatuar neni 69 me përpikëri. Komisioni i vlerësimit qe ka qene profesional ,përbërja ka qene 2 vendor dhe një ndërkombëtar. Gjatë vlerësimit te ofertave ,ne ofertën e O.E. te shpërblyer ka konstatuar se referenca është ne të ofertë por nuk është lista e kontratës duke u mbështet ne nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe nenin 10,1 te Udhëzues Nr-001 2023 për prokurimin publik citat: Lista e kontratave të Mund të kërkohen 69 realizuara nuk është informata sqaruese dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca/certifikatë pranimit/kontrata) A.K. ka vepruar sipas neneve te cekura me lart dhe i keni pranuar ne afat ligjor dhe atë: -Pagesat nga viti 2017 e deri me 2023,kontratën ne mes te palëve CISCO dhe 3 CIS J S C qe është vlerësuar nga komisioni qe është plotësuar kërkesa sipas nenit 69 të LPP-së. Dokumente e tilla komisioni i vlerësimit te ofertave nga ana e Autoritetit Kontraktues i ka cilësuar si prova te bazuara dhe dëshmi për kryerje të projekteve me sukses për implementimin e rrjetit Jopublik 5G (Rrjeti Privat) dhe e ka cilësuar OE "3ClS & Interadria" të përgjegjshëm nga ana e Kapaciteti teknik dhe profesional. - Ofertuesi "Grup i Operatorëve Ekonomik 3 CIS JSC; InterAdria L.L.C.t — i ka plotësuar kërkesat lidhur me përshtatshmërinë teknike, respektivisht i ka përmbushur Kërkesat teknike mandatorë për Sistemin 5G-SNPN, si dhe një numër të kërkesave opcionale duke mbledhur gjithsejtë 8 pikë nga gjithsejtë 18 të mundshme. Konstatimi është i pa baze.

Përgjigjeje për anëtarin e dytë të renditur Ofertuesi "Grup i Operatorëve Ekonomik Wire Labs Kosova L L.C.; A & B engineering SH.P.K.; WIDELITY L.LC; Wireless laboratories INC Operatori i renditur me pike me numër rendor 2 e vërtet është se ka referencë për realizimin e kontratave ne vlerë për 5 milion €, sipas kërkesës se dosje dhe njoftimit te kontratës ku keni pas qasje dhe keni kërkuar te ju dërgojmë, por e vërtet ne e kemi shpall si operator te pa suksesshëm sepse nuk kemi kërkuar dokumente shtesë nga operatori sipas nenit 72 për listë te kontratave sepse nuk ka qen ne renditje për shpërblim dhe dokumente ne i kërkoj vetëm për operatorin te cilin e shpërblejmë, nëse operatori i renditur me numër 1 dështon, atëherë mund te kërkoj dokument te cilin mungon dhe lejon Ligji. Por nuk do te thotë se është i pa përgjegjshëm. Konstatimi është i pa baze."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 10.11.2023 ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 870/23 ndërsa me datë 10.11.2023 Paneli Shqyrtues ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 874/23.

Lidhur me ankesën nr. 870/23 me datë 20.11.2023 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese/teknik me nr. 2023/0870 me rekomandimet si në vijim: *"Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim."*

Lidhur me ankesën nr. 874/23 me datë 27.11.2023 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese/teknik me Nr. 2023/0874 me rekomandimet si në vijim: *"Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim."*

Raportin e ekspertizës me nr.870/23 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertes shqyrtuese, ndërsa OE nuk ka dhen përgjigje lidhur me raportin e ekspertes shqyrtuese.

Raportin e ekspertizës me nr.874/23 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertes shqyrtuese, ndërsa OE Pajtohet me raportin e ekspertes shqyrtuese.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertes shqyrtuese, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Wire Labs Kosova" L.L.C., ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/0870 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim Hyrës: "*Parashtruesi i ankesës (Wire labs Kosova L.L.C) me datë 24.10.2023 ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim në AK. Me datë 26.10.2023 AK ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Pretendimi ankimor :OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka*

plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për kapacitetin teknik dhe profesional, për kontrata të përfunduar me sukses. Rrethanat e çështjes:AK në dosjen e tenderit të publikuar ka vendosur kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional si vijon: "1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për implementimin e Rrjetit Jopublik 5G (Rrjeti Privat) në vlerë minimale prej 2,000,000.00 (dy milionë) Euro." Për këtë kërkesë, dëshmia e kërkuar dokumentare është përcaktuar si vijon: "1. Një listë e kontratave të përfunduara, duke plotësuar të Dosjes së Tenderit ku duhet të specifikohen titulli i kontratës, shuma e kontratës, data e fillimit dhe data e përfundimit dhe përfituesi, si dhe referencat ose certifikatat për Kryerja e punëve dhe shërbimeve duhet ti bashkëngjitet listës."

Në tenderin e dorëzuar nga OE ekonomik nuk është dorëzuar lista e kontratave sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Megjithatë është dorëzuar Referenca e lëshuar nga "Cisco" e cila mbanë datën 08.03.2023 me titull "Letër referencë për Shërbimet Profesionale të 3ClS J.S.C për Cisco", me përmbajtjen si vijon: Po e shkruaj këtë letër për të shprehur rekomandimin tonë më të lartë për "3ClS", si partner i preferuar në ofrimin e shërbimeve të jashtëzakonshme profesionale për Cisco-n, për zbatimin e Rrjeteve 5G publike dhe jopublike për një periudhë kohore prej gjashtë vjetësh, me shërbime të ofruara prej 51 milionë dollarë Amerikan në vit. Që nga fillimi i partneritetit tonë në 2017, 3ClS ka demonstruar vazhdimisht një angazhim të palëkundur ndaj përsosmërisë, ekspertizës teknike dhe një kuptim të thellë të kërkesave tona në peizazhin me zhvillim të shpejtë të teknologjisë 5G. Kontributet e tyre kanë luajtur një rol integral në krijimin dhe mirëmbajtjen e suksesshme të infrastrukturës së rrjetit tonë 5G. Gjatë këtyre gjashtë viteve, përkushtimi dhe aftësia e 3ClS ka qenë e jashtëzakonshme. Jo vetëm që kanë ofruar zgjidhje me cilësi të lartë, por gjithashtu kanë treguar përshtatshmëri të jashtëzakonshme në adresimin e sfidave unike të paraqitura nga zbatimet publike dhe jopublike të rrjetit 5G. Aftësia e tyre për të bashkëpunuar pa probleme me ekipet tona të brendshme, për të kuptuar nevojat tona specifike dhe për të ofruar zgjidhje të përshtatura ka qenë një faktor kyç në suksesin e projekteve tona. Përveç kompetencës së tyre teknike, profesionalizmi dhe ekzekutimi në kohë, 3ClS ka kontribuar ndjeshëm në përhapjen efikase të nismave tona të rrjetit 5G. Dorëzimi i tyre i vazhdueshëm i rezultateve brenda afateve të ngushta kohore ka qenë i rëndësishëm dhe na ka ndihmuar të arrijmë objektivat tona operacionale pa kompromentuar cilësinë. Si përfundim, me kënaqësi të madhe po jap këtë letër referimi për 3ClS. Ekspertiza, përkushtimi dhe fryma e tyre bashkëpunuese kanë pasur një ndikim thelbësor në projektet tona të zbatimit të rrjetit 5G. Ne kemi gëzuar një partneritet me përfitim reciprok dhe jemi të bindur se çdo organizatë që angazhohet me 3ClS do të përfitojë shumë nga profesionalizmi, aftësitë teknike dhe angazhimi i tyre për përsosmëri. Nëse keni ndonjë pyetje ose keni nevojë për informacione të mëtejshme, ju lutemi mos hezitoni të më kontaktoni. Ne presim mundësinë e vazhdimit të partneritetit tonë me 3ClS në të ardhmen."

AK me datë 30.09.2023, gjatë vlerësimit të tenderëve ka kërkuar sqarime shtesë nga Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë: "2.Listen e kontratës nuk e keni sipas kërkesës dhe dëshmisë se kërkuar pore keni një referenca (pa shume totale par vetëm përafërsish një milion dollar për vite) për një kontrata nëse i posedoni na i dërgoni me date te theksuar para dorëzimit te ofertave. Ju e keni dorëzuar reference, por ne kërkojm listën e kontratës e cila e specifikon se cilat shërbime i keni krye ne kuadër te kontratës, kërkesa behet sipas nenit 72 te LPP-se. Operator te

nderuar informatat ti dërgoni përmes sistemit e-prokurim deri me datën 04/10/2023, ne te kundërtën oferta e juaj refuzohet."

Grupi i OE-ve me datë 04.10.2023 në ora 11:08 ka dorëzuar dokumentet shtesë.

1. *Deklaratë për sqarime shtese, në të cilën theksohet: Ne baze te kërkesës suaj për sqarime shtese te datës 30/09/2023, ju lutem gjeni te bashkëngjitur folderin e arkivuar me informatat e kërkuara si ne vijim: 1.Ne folderin bazë mund të gjeni referencën e përshkrimit të punës se inxhinierit e cila është e nënshkruar me klientin dhe të cilës duhet ti përmbahemi ne ofrimin e shërbimit në bazë të specifikave te parashtruara ne dokument. Në të njëjtin dokument është i caktuar çmimi për njësi të cilin e kemi redaktuar për shkak të NDA qe kemi me klientin. 2.Ne secilin folder shtese mund ti gjeni PO-në dhe faturimi respektiv për secilin PO. Ne PO gjendet gjithashtu edhe data e fillimit dhe përfundimit te shërbimit. 3.Faturat dhe PO-të e ofruara janë nga fundi i viti 2019 deri me sot dhe kapin vlerën rreth mbi 3 Milion USD. 4. Gjithashtu ne folderin baze mund te gjeni një tabele ne excel me përmbledhje të PO-ve qe gjenden brenda secilit folder.*

2. *Së bashku me shkresë janë dorëzuar edhe 29 Purchase Order (Urdhërblerje apo porosi të shërbimit) dhe 130 fatura të lëshuara nga anëtari i grupit-3CIS sipas urdhërblerjeve përkatëse. Urdhërblerjet janë lëshuar nga data 6 qershor 2019 deri me datë 23 gusht 2023.*

3. *Dokumenti "Cisco Services Subcontractor Statement of Work". Në këtë dokument përshkruhen shërbimet që ofrohen nga 3 CIS JSC për CISCO të cilat në përshkrimin e çmimit kanë emërtimin " Multi Project Support Services" Dokumenti është nënshkruar në formë elektronike nga palët dhe në lidhje me afatin shënohet se ky dokument rregullohet bazuar në Marrëveshja e Nënkontraktorit të Shërbimeve Profesionale (PSSA) në fuqi nga 21 mars 2018.*

Në të njëjtën ditë (04.10.2023) në ora 13:15 është dorëzuar edhe dokumenti "Lista e kontratave 3CIS IA". Dokumenti ka fushat si vijon: Numri i kontratës, Data, Vlera e faturimit/kontratës, Data e fillimit te shërbimit, Data e mbarimit të shërbimit. Të dhënat e paraqitura në dokument janë identike në dokumentin "Përmbledhje e PO-ve", pra në fushë Numri i kontratës janë shënuar numrat e urdhërblerjes. Ndërsa nuk është shënuar "titulli i kontratës" sikurse kërkohet.

Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 26.10.2023, AK ka dhënë arsyetimin si vijon: "Ne përgjigje te kërkesës suaj për rishqyrtim sipas Nenit 108A te Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik te Republikës se Kosovës, ju njoftojmë se Autoriteti Kontraktues pretendimin për liste te kontratave dhe referenca. -Konstatimi i shkeljes se nenit 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Vlerësimi i ofertave është bere ne harmoni me neni 59 është kontrolluar dhe është verifikuar. aq sa kemi pas kapacitete ligjore. Konstatimi eshët i pa baze. -Konstatimi i shkeljes se Neni 64 Dështmitë e kërkesave. A.K. qe do te thotë komisioni vlerësues ka zbatuar neni 64 me përpikëri dhe vlerësimi ofertave është bere sipas kërkesës se komisionit të vlerësimit ne kemi bere kërkesë për dokument shtesë sipas nenit 72 të

LPP-së dhe 10.1 .dhe të Udhëzues Nr-001_2023 për prokurimin publik për listën e kontratave dhe brenda afatit kemi pranuar dokumentin ose dëshminë që do të thotë nuk është bere shkelje e nenit 64 .Konstatimi është i pa baze. -Konstatimi i shkeljes se nenit 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale A.K. qe do të thotë komisioni vlerësues ka zbatuar neni 69 me përpikëri. Komisioni i vlerësimit qe ka qene profesional, përbërja ka qene 2 vendor dhe një ndërkombëtar. Gjate vlerësimit të ofertave, në ofertën e O.E. të shpërblyer ka konstatuar se referenca është ne të oferte por nuk është lista e kontratës duke u mbështet ne nenin 59.2 dhe 72 te LPP-se dhe nenin 10.1 te udhëzuesi Nr-001_2023 për prokurimin publik citat: Lista e kontratave te Mund te kërkohen 69 realizuara nuk është informata sqaruese dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca / certifikata e pranimit / kontrata) A.K. ka vepruar sipas neneve te cekura me lart dhe i kemi pranuar ne afat ligjor dhe atë: -Pagesat nga viti 2017 e deri me 2023,kontraten ne mes te palëve CISCO dhe 3 CIS JSC qe është vlerësuar nga komisioni qe është plotësuar kërkesa sipas nenit 69 te LPP-se. Dokumente e tilla komisioni i vlerësimit te ofertave nga ana e Autoritetit Kontraktues i ka cilësuar si prova te bazuara dhe dëshmi për kryerje te projekteve me sukses për implementimin e Rrjetit Jopublik SG (Rrjeti Privat) dhe e ka cilësuar OE "3CIS & lnteradria" te përgjegjshëm nga ana e Kapaciteti teknik dhe profesional. Konstatimi është i pa baze."

-- Vlerësimi i ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik

Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se dëshmitë e dorëzuara nga Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë në tender dhe sqarimet shtesë të kërkuara nga AK përshkruajnë shërbime të kryera nga anëtari i GOE (3 CIS) sipas informatave në njëzet e nëntë (29) urdhërblerje dhe njëqind e tridhjetë (130) fatura me shumat përkatëse. Megjithatë, as në sqarimet e dërguara me datë 04.10.2023, Grupi i OE-ve të rekomanduar nuk ka dorëzuar listën e kontratave me informatat përkatëse të kërkuara në dosjen e tenderit, pasi që lista e dorëzuar përmban numrat e urdhërblerjeve dhe jo të kontratave si dhe nuk ka titullin e kontratës. Gjithashtu, nuk janë dorëzuar kontrata, mirëpo është dorëzuar dokumenti-Përshkrimi i punës e cila bazohet në "Marrëveshja e Nënkontraktorit të Shërbimeve Profesionale (PSSA)". Përkundër që AK në vendimin e datës 26.10.2023, në arsyetimin për refuzimin deklaron se Grupi i OE-ve ka dorëzuar kontratë në mes të palëve, vetë anëtari i grupit në dokumentin sqarues të dorëzuar me datë 04.10.2023 nuk e thekson se dorëzon kontratë në mes të palëve por thekson si vijon: "Ne folderin baze mund te gjeni referencën e përshkrimit te punës se inxhinierit e cila është e nënshkruar me klientin dhe te cilës duhet ti përmbahemi ne ofrimin e shërbimit ne baze të specifikave të parashtruara ne dokument. Në të njëjtin dokument është i caktuar çmimi për njësi të cilin e kemi redaktuar për shkak te NDA qe kemi me klientin." Më tej, disa nga Urdhërblerjet dhe faturat janë marrë të mirëqena nga AK përkundër që afati i përmbushjes në to shënohet të jetë në datat pas njoftimit për kontratë.

Andaj, eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se ekzistojnë dëshmi që anëtari i grupit "3CIS" ka kryer shërbime e telekomunikacionit për kompaninë "Cisco" në vlerën e kërkuar, megjithatë referenca e lëshuar nga "Cisco" dhe dokumentet shtesë të pranuara gjatë sqarimeve nuk dëshmojnë se përmbushet kërkesa e përcaktuar nga AK në dosjen e tenderit, e që është: "Kërkesa1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për

implementimin e Rrjetit Jopublik 5G (Rrjeti Privat) në vlerë minimale prej 2,000,000.00 (dy milionë) Euro. Dëshmia: 1. Një listë e kontratave të përfunduara, duke plotësuar të Dosjes së Tenderit ku duhet të specifikohen titulli i kontratës, shuma e kontratës, data e fillimit dhe data e përfundimit dhe përfituesi, si dhe referencat ose certifikatat për Kryerja e punëve dhe shërbimeve duhet ti bashkëngjitet listës." Konkretisht, Grupi i OE-ve nuk ka prezantuar informatë për kontratat të përfunduar para njoftimit për kontratë sikurse është kërkuar nga AK, rrjedhimisht vlerësimi dhe vendimi i AK-së me informatat e pranuara është në kundërshtim me nenin 59, paragrafi 4 i LPP-së ku thuhet "AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit." Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme, pretendimi ankimor është i bazuar.

Konstatimet në raportin e ekspertes shqyrtuese mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertes shqyrtuese janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Wire Labs Kosova" L.L.C., i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertes shqyrtuese. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë te gjitha faktet dhe provat. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Wire Labs Kosova" L.L.C., janë të bazuara**.**

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues"Cacttus" Sh.a.,Ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/0874 ka vlerësuar se:

Sqarim Hyrës: "*Parashtruesi i ankesës OE Cacttus Sh.a (më tej OE ankues) me datë 24.10.2023 ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim në AK. Me datë 26.10.2023 AK ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.* ***Pretendimi ankimor 1*** *OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për kapacitetin teknik dhe profesional, për kontrata të përfunduar me sukses.* ***Rrethanat e çështjes:*** *AK në dosjen e tenderit të publikuar ka vendosur kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional si vijon: "1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për implementimin e Rrjetit Jopublik 5G (Rrjeti Privat) në vlerë minimale prej 2,000,000.00 (dy milionë) Euro." Për këtë kërkesë, dëshmia e kërkuar dokumentare është përcaktuar si vijon: "1. Një listë e kontratave të përfunduara, duke plotësuar të Dosjes së Tenderit ku duhet të specifikohen titulli i kontratës, shuma e kontratës, data e fillimit dhe data e përfundimit dhe përfituesi, si dhe referencat ose certifikatat për Kryerja e punëve dhe shërbimeve duhet ti bashkëngjitet listës."*

Në tenderin e dorëzuar nga OE ekonomik nuk është dorëzuar lista e kontratave sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Megjithatë është dorëzuar Referenca e lëshuar nga "Cisco" e cila mbanë datën 08.03.2023 me titull "Letër referencë për Shërbimet Profesionale të 3ClS J.S.C për Cisco", me përmbajtjen si vijon: Po e shkruaj këtë letër për të shprehur rekomandimin tonë më të lartë për "3ClS", si partner i preferuar në ofrimin e shërbimeve të jashtëzakonshme profesionale për Cisco-n, për zbatimin e Rrjeteve 5G publike dhe jopublike për një periudhë kohore prej gjashtë vjetësh, me shërbime të ofruara prej 51 milionë dollarë Amerikan në vit. Që nga fillimi i partneritetit tonë në 2017, 3ClS ka demonstruar vazhdimisht një angazhim të palëkundur ndaj përsosmërisë, ekspertizës teknike dhe një kuptim të thellë të kërkesave tona në

peizazhin me zhvillim të shpejtë të teknologjisë 5G. Kontributet e tyre kanë luajtur një rol integral në krijimin dhe mirëmbajtjen e suksesshme të infrastrukturës së rrjetit tonë 5G. Gjatë këtyre gjashtë viteve, përkushtimi dhe aftësia e 3ClS ka qenë e jashtëzakonshme. Jo vetëm që kanë ofruar zgjidhje me cilësi të lartë, por gjithashtu kanë treguar përshtatshmëri të jashtëzakonshme në adresimin e sfidave unike të paraqitura nga zbatimet publike dhe jopublike të rrjetit 5G. Aftësia e tyre për të bashkëpunuar pa probleme me ekipet tona të brendshme, për të kuptuar nevojat tona specifike dhe për të ofruar zgjidhje të përshtatura ka qenë një faktor kyç në suksesin e projekteve tona. Përveç kompetencës së tyre teknike, profesionalizmi dhe ekzekutimi në kohë, 3ClS ka kontribuar ndjeshëm në përhapjen efikase të nismave tona të rrjetit 5G. Dorëzimi i tyre i vazhdueshëm i rezultateve brenda afateve të ngushta kohore ka qenë i rëndësishëm dhe na ka ndihmuar të arrijmë objektivat tona operacionale pa kompromentuar cilësinë. Si përfundim, me kënaqësi të madhe po jap këtë letër referimi për 3ClS. Ekspertiza, përkushtimi dhe fryma e tyre bashkëpunuese kanë pasur një ndikim thelbësor në projektet tona të zbatimit të rrjetit 5G. Ne kemi gëzuar një partneritet me përfitim reciprok dhe jemi të bindur se çdo organizatë që angazhohet me 3ClS do të përfitojë shumë nga profesionalizmi, aftësitë teknike dhe angazhimi i tyre për përsosmëri. Nëse keni ndonjë pyetje ose keni nevojë për informacione të mëtejshme, ju lutemi mos hezitoni të më kontaktoni. Ne presim mundësinë e vazhdimit të partneritetit tonë me 3ClS në të ardhmen." AK me datë 30.09.2023, gjatë vlerësimit të tenderëve ka kërkuar sqarime shtesë nga Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë: "2.Listen e kontratës nuk e keni sipas kërkesës dhe dëshmisë se kërkuar pore keni një referenca (pa shume totale par vetëm përafërsish një milion dollar për vite) për një kontrata nëse i posedoni na i dërgoni me date te theksuar para dorëzimit te ofertave. Ju e keni dorëzuar reference, par ne kërkoj listën e kontratës e cila e specifikon se cilat shërbime i keni krye ne kuadër te kontratës, kërkesa behet sipas nenit 72 te LPP-se. Operator te nderuar informatat ti dërgoni përmes sistemit e-prokurim deri me datën 04/10/2023, ne te kundërtën oferta e juaj refuzohet."Grupi i OE-ve me datë 04.10.2023 në ora 11:08 ka dorëzuar dokumentet shtesë.

1. *Deklaratë për sqarime shtese, në të cilën theksohet: Ne baze të kërkesës suaj për sqarime shtese te datës 30/09/2023, ju lutem gjeni te bashkëngjitur folderin e arkivuar me informatat e kërkuara si ne vijim: 1.Ne folderin baze mund te gjeni referencën e përshkrimit te punës se inxhinierit e cila është e nënshkruar me klientin dhe te cilës duhet ti përmbahemi ne ofrimin e shërbimit ne baze të specifikave te parashtruara ne dokument. Ne te njëjtin dokument është i caktuar çmimi për njësi te cilin e kemi redaktuar për shkak te NDA qe kemi me klientin. 2.Ne secilin folder shtese mund ti gjeni PO-ne dhe faturimi respektiv për secilin PO. Ne PO gjendet gjithashtu edhe data e fillimit dhe përfundimit të shërbimit. 3.Faturat dhe PO-të e ofruara janë nga fundi i viti 2019 deri me sot dhe kapin vlerën rreth mbi 3 Milion USD. 4. Gjithashtu ne folderin baze mund të gjeni një tabele ne excel me përmbledhje të PO-ve qe gjenden brenda secilit folder.*

2. *Së bashku me shkresë janë dorëzuar edhe 29 Purchase Order (Urdhërblerje apo porosi të shërbimit) dhe 130 fatura të lëshuara nga anëtari i grupit-3CIS sipas urdhërblerjeve përkatëse. Urdhërblerjet janë lëshuar nga data 6 qershor 2019 deri me datë 23 gusht 2023.*

3. *Dokumenti "Cisco Services Subcontractor Statement of Work". Në këtë dokument përshkruhen shërbimet që ofrohen nga 3 CIS JSC për CISCO të cilat në përshkrimin e çmimit kanë emërtimin " Multi Project Support Services" Dokumenti është nënshkruar në formë elektronike nga palët dhe në lidhje me afatin shënohet se ky dokument rregullohet bazuar në Marrëveshja e Nënkontraktorit të Shërbimeve Profesionale (PSSA) në fuqi nga 21 mars 2018.*

"Në të njëjtën ditë (04.10.2023) në ora 13:15 është dorëzuar edhe dokumenti "Lista e kontratave 3CIS IA". Dokumenti ka fushat si vijon: Numri i kontratës, Data, Vlera e faturimit/kontratës, Data e fillimit te shërbimit, Data e mbarimit të shërbimit. Të dhënat e paraqitura në dokument janë identike në dokumentin "Përmbledhje e PO-ve", pra në fushë Numri i kontratës janë shënuar numrat e urdhërblerjes. Ndërsa nuk është shënuar "titulli i kontratës" sikurse kërkohet.

Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 26.10.2023, AK ka dhënë arsyetimin si vijon: "Ne përgjigje te kërkesës suaj për rishqyrtim sipas Nenit 108A te Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, ju njoftojmë se Autoriteti Kontraktues pretendimin për liste te kontratave dhe referenca".

-Konstatimi i shkeljes se nenit 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i TenderëveVlerësimi i ofertave është bere ne harmoni me neni 59 është kontrolluar dhe është verifikuar aq sa kemi pas kapacitete ligjore. Konstatimi eshët i pa baze.-Konstatimi i shkeljes se Neni 64 Dëshmitë e kërkesave.A.K. qe do te thotë komisioni vlerësues ka zbatuar neni 64 me përpikëri dhe vlerësimi ofertave është bere sipas kërkesës se komisionit te vlerësimit ne kemi bere kërkesë për dokument shtesë sipas nenit 72 te LPP-se dhe 10.1 .dhe të udhëzues Nr-001_2023 për prokurimin publik për listën e kontratave dhe brenda afatit kemi pranuar dokumentin ose dëshminë qe do të thotë nuk është bere shkelje e nenit 64 .Konstatimi është i pa bazë.-Konstatimi i shkeljes se nenit 69 Aftesia Teknike dhe/ose Profesionale A.K. qe do të thotë komisioni vlerësues ka zbatuar neni 69 me përpikëri. Komisioni i vlerësimit qe ka qene profesional, përbërja ka qene 2 vendor dhe një ndërkombëtar. Gjate vlerësimit te ofertave, ne ofertën e O.E. të shpërblyer ka konstatuar se referenca është ne të oferte por nuk është lista e kontratës duke u mbështet ne nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe nenin 10.1 te udhëzues Nr-001_2023 për prokurimin publik citat: Lista e kontratave të Mund të kërkohen 69 realizuara nuk është informata sqaruese dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë (referenca / certifikata e pranimit / kontrata) A.K. ka vepruar sipas neneve te cekura me lart dhe i kemi pranuar ne afat ligjor dhe atë: -Pagesat nga viti 2017 e deri me 2023,kontraten ne mes të palëve CISCO dhe 3 CIS JSC qe është vlerësuar nga komisioni qe është plotësuar kërkesa sipas nenit 69 te LPP-se. Dokumente e tilla komisioni i vlerësimit të ofertave nga ana e Autoritetit Kontraktues i ka cilësuar si prova te bazuara dhe dëshmi për kryerje te projekteve me sukses për implementimin e Rrjetit Jopublik SG (Rrjeti Privat) dhe e ka cilësuar OE "3CIS & lnteradria" te përgjegjshëm nga ana e Kapaciteti teknik dhe profesional. Konstatimi është i pa baze."

-Vlerësimi i ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 1:

"Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se dëshmitë e dorëzuara nga Grupi i OE-ve të rekomanduar për kontratë në tender dhe sqarimet shtesë të kërkuara nga AK përshkruajnë shërbime të kryera nga anëtari i GOE (3 CIS) sipas informatave në njëzet e nëntë (29) urdhërblerje dhe njëqind e tridhjetë (130) fatura me shumat përkatëse. Megjithatë, as në sqarimet e dërguara me datë 04.10.2023, Grupi i OE-ve nuk ka dorëzuar listën e kontratave me informatat përkatëse të kërkuara në dosjen e tenderit, pasi që lista e dorëzuar pasi janë dorëzuar dokumentet tjera përmban numrat e urdhërblerjeve dhe jo të kontratave si dhe nuk ka titullin e kontratës. Gjithashtu, nuk është dorëzuar kontratë, mirëpo është dorëzuar dokumenti- Përshkrimi i punës e cila bazohet në "Marrëveshja e Nënkontraktorit të Shërbimeve Profesionale (PSSA)". Përkundër që AK në vendimin e datës 26.10.2023, në arsyetimin për refuzimin deklaron se Grupi i OE-ve ka dorëzuar kontratë në mes të palëve, vetë anëtari i grupit në dokumentin sqarues të dorëzuar me datë 04.10.2023 nuk e thekson se dorëzon kontratë në mes të palëve por thekson si vijon: "Ne folderin baze mund te gjeni referencën e përshkrimit te punës se inxhinierit e cila është e nënshkruar me klientin dhe te cilës duhet ti përmbahemi ne ofrimin e shërbimit ne baze te specifikave te parashtruara ne dokument. Ne te njëjtin dokument është i caktuar çmimi për njësi te cilin e kemi redaktuar për shkak te NDA qe kemi me klientin." Më tej, disa nga Urdhërblerjet dhe faturat janë marrë të mirëqena nga AK përkundër që afati i përmbushjes në to shënohet të jetë në datat pas njoftimit për kontratë. Andaj, eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se ekzistojnë dëshmi që anëtari i grupit "3CIS" ka kryer shërbime e telekomunikacionit për kompaninë "Cisco" në vlerën e kërkuar, megjithatë referenca e lëshuar nga "Cisco" dhe dokumentet shtesë të pranuara gjatë sqarimeve nuk dëshmojnë se përmbushet kërkesa e përcaktuar nga AK në dosjen e tenderit, e që është: "Kërkesa1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për implementimin e Rrjetit Jopublik 5G (Rrjeti Privat) në vlerë minimale prej 2,000,000.00 (dy milionë) Euro. Dëshmia: 1. Një listë e kontratave të përfunduara, duke plotësuar të Dosjes së Tenderit ku duhet të specifikohen titulli i kontratës, shuma e kontratës, data e fillimit dhe data e përfundimit dhe përfituesi, si dhe referencat ose certifikatat për Kryerja e punëve dhe shërbimeve duhet ti bashkëngjitet listës." Konkretisht, Grupi i OE-ve nuk ka prezantuar informatë për kontratat të përfunduar para njoftimit për kontratë sikurse është kërkuar nga AK, rrjedhimisht vlerësimi dhe vendimi i AK-së me informatat e pranuara është në kundërshtim me nenin 59, paragrafi 4 i LPP-së ku thuhet "AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit." Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme, pretendimi ankimor është i bazuar."

Pretendimi ankimor 2

OE ankues pretendon se zgjidhja teknike e ofruar nga GOE të rekomanduar për kontratë nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe krijon kosto shtesë për AK-në dhe nuk janë plotësuar kërkesat në tabelën 6 të dosjes së tenderit.

***Rrethanat e çështjes**; "Në dokumentin e zgjidhjes teknike të ofertuar, theksohet se GOE ofertojnë me zgjidhjen Nokia Digital Automation Cloud (Nokia DAC). Më tej në kapitullin*

Nokia DAC Solution Overview ndër të tjera shënohet " [..] zgjidhja e Nokia DAC u ofrohet klientëve si një kombinim i komponentëve lokalë të harduerit dhe shërbimeve të zgjedhura të cloud, të cilat ofrohen në bazë të periudhës së dakorduar." ?Në dokumentin teknik, në pjesën 5G Core, në faqen 16 Licencat janë të bazuara në abonim (subscription) dhe janë të vlefshme për një periudhë totale prej 4 vitesh (48 muaj). Zbatimi i fushëveprimit të projektit është caktuar të dorëzohet brenda vitit të parë (6 – 12 muaj) dhe licencat do të jenë të vlefshme edhe për 3 vjet (36 muaj) periudhë shtesë kohore. Në dokumentin teknik të dorëzuar nuk është paraqitur edhe tabela me kërkesat e përcaktuara në Tabela 6: Kërkesat për infrastrukturën e virtualizimit dhe nivelet e menaxhimit, pikat (2.9, 2.10, 2.13 dhe 2.14). Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 26.10.2023, AK ka dhënë arsyetimin si vijon "Komisioni ka vlerësuar se oferta është teknikisht e realizueshme sipas kërkesave në tender, qe zgjidhja e propozuar është teknikisht e shëndoshë dhe se përmbushë kërkesat e specifikuara. Kjo është thelbësore pasi hedh themelet për një rrjetë të suksesshme.Zgjidhja me një shitës (ang. vendor): Një përparësi e kësaj oferte është se të gjitha pajisjet vijnë nga një shitës i vetëm me përvojë të gjerë, Nokia. Përdorimi i një zgjidhjeje me një shitës të vetëm mund të thjeshtoje integrimin e rrjetit dhe të zvogëlojë problemet e përputhshmërisë. pasi të gjithë komponentët janë projektuar për të punuar pa probleme se bashku. Përvoja e Nokia-s ne këtë industri rrit me tej besimin ne besueshmërinë dhe performancen e pajisjeve.Planifikimi i detajuar i rrjetit: Planifikimi i detajuar i ofertës për aspektet e rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm është një aspekt pozitiv për tu lavdëruar. Planifikimi i detajuar është thelbësor për optimizmin e mbulueshmërisë, kapacitetit dhe perfo1mances se rrjetit duke siguruar qe zgjidhja mund të plotësojë kërkesat e specifikuara dhe të ofroje një shërbim me cilësi të lartë."

-Vlerësimi i ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 2:

Eksperti teknik sqarojnë se në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, përkatësisht në arsyetim nuk sqarohet nëse janë trajtuar pretendimet në lidhje me ofertën teknike. Në lidhje me zgjidhjen e ofertuar, AK ka deklaruar që zgjidhja e ofertuar nga GOE të rekomanduar për kontratë nga një shitës i vetëm është përparësi, megjithatë pretendimet për çështjet e sigurisë që ndërlidhen me opsionin e Nokia DAC Solution, respektivisht menaxhimin nga Nokia DAC regional cloud AK nuk e ka trajtuar. Më tej, marrë për bazë faktin se ashtu sikurse është paraqitur mesipër, në ofertën teknike licensat përfshijnë vetëm periudhën prej 48 muajve, gjë që mund të ndikojë në koston e këtij projekti (shpenzimet rrjedhëse përveç furnizimit dhe implementimit të projektit). Andaj, këto janë disa çështje thelbësore që duhet të trajtohen nga AK në mënyrë që të konstatohet se plotësohen të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe përcaktojnë zgjidhjen me të favorshme ekonomike për AK-në. Më tej përkundër që në raportin e vlerësimit deklarohet se përmbushën kërkesat e specifikuara, në dokumentin teknik të ofertës së GOE të rekomanduar është evidente se nuk janë përshkruar dhe plotësuar kërkesat e përcaktuar si mandatore (2.9, 2.10, 2.13 dhe 2.14) tek Tabela 6. Si përfundim, duke marrë për bazë sqarimet e mësipërme, eksperti teknik vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 3

OE ankues pretendon se Grupi i OE-ve: Wire Labs Kosova L.L.C.; A&B engineering SH.P.K.; WIDELITY L.LC; Wireless laboratories INC, nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për kapacitetin teknik dhe profesional, për kontrata të përfunduar me sukses.

Rrethanat e çështjes *; AK në dosjen e tenderit të publikuar ka vendosur kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional si vijon: "1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për implementimin e Rrjetit Jopublik 5G (Rrjeti Privat) në vlerë minimale prej 2,000,000.00 (dy milionë) Euro." Për këtë kërkesë, dëshmia e kërkuar dokumentare është përcaktuar si vijon: "1.Një listë e kontratave të përfunduara, duke plotësuar të Dosjes së Tenderit ku duhet të specifikohen titulli i kontratës, shuma e kontratës, data e fillimit dhe data e përfundimit dhe përfituesi, si dhe referencat ose certifikatat për Kryerja e punëve dhe shërbimeve duhet ti bashkëngjitet listës." Në tenderin e dorëzuar nga GOE Wire Labs Kosova L.L.C.; A&B engineering SH.P.K.; WIDELITY L.LC; Wireless laboratories INC është dorëzuar dokumenti nga kompania "AT&T"e cila mban datën 20.08.2023 me përmbajtjen si vijon: "Unë, James Wagner, Drejtor Ekzekutiv i AT&T Mobility Labs., rekomandoj Wireless Laboratories, Inc. për ekspertizën e tyre të jashtëzakonshme në fushën e inxhinierisë celulare. Me mbi 30 vjet përvojë dhe 25 vite angazhim me ne, ata kanë trajtuar vazhdimisht projektet më komplekse me aftësi, përkushtim dhe sukses të jashtëzakonshëm. Qëndrimi i tyre në AT&T Mobility Labs është dëshmi e kuptimit të tyre të thellë të industrisë dhe aftësisë së tyre për të nxitur inovacionin e vazhdueshëm. Wireless Laboratories dhe themeluesi i tyre Robert Hamblet demonstrojnë vazhdimisht një aftësi të mprehtë për zgjidhjen e problemeve, një përkushtim të fortë për punën në grup dhe një histori të gjatë të ekzekutimit të suksesshëm të projektit. Depërtimi i tyre i thellë dhe kontributet e shumta kanë lënë padyshim një ndikim të qëndrueshëm në peizazhin e inxhinierisë celulare. Wireless Laboratories Inc., në 3 vitet e fundit ka zbatuar projekte, duke përfshirë instalime laboratorike mbi 5 milion dollarë Amerikan." Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 26.10.2023, AK ka dhënë arsyetimin si vijon: "Përgjigjeje për anëtarin e dytë të renditur Ofertuesi "Grup i Operatoreve Ekonomik Wire Labs Kosova L.L.C.; A & B engineering SH.P.K.; WIDELITY L.LC; Wireless laboratories INC Operatori i renditur me pike me numër rendor 2 e vërtet është se ka reference për realizimin e kontratave ne vlere për 5 milion €, sipas kërkesës se dosje dhe njoftimit të kontratës ku keni pas qasje dhe keni kërkuar të ju dërgojmë, par e vërtet ne e kemi shpall si operator të pa suksesshëm sepse nuk kemi kërkuar dokumente shtese nga operatori sipas nenit 72 për liste te kontratave sepse nuk ka qen ne renditje për shpërblim dhe dokumente ne i kërkoj vetëm për operatorin te cilin e shpërblejmë, nëse operatori i renditur me numër 1 dështon, atëherë mund të kërkoj dokument të cilin mungon dhe lejon Ligji. Por nuk do të thotë se është i pa përgjegjshëm. Konstatimi është i pa baze."*

-Vlerësimi i ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik lidhur me pretendimin ankimor 3

Ekspertët shqyrtues dhe teknikët sqarojnë se sipas dokumenteve procedurale lidhur me vlerësimin e kapacitetit teknik dhe profesional, Grupi i OE-ve, Wire Labs Kosova L.L.C.; A & B engineering SH.P.K.; WIDELITY L.LC; Wireless laboratories INC, ka dorëzuar vetëm një

dokument referencë ose rekomandim nga kompania AT&T. Sipas dokumentacionit të disponueshëm, Autoriteti Kontraktues (AK) nuk ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me listën e kontratave, edhe pse në njoftimin për kontratë kërkohet dëshmi në formën e: Një liste të kontratave të përfunduara, duke përfshirë informacionin për titullin e kontratës, vlerën e saj, datat e fillimit dhe përfundimit, si dhe përfituesin, si dhe referencat ose certifikatat për kryerjen e punëve dhe shërbimeve që duhet të bashkëngjiten listës.

Pra, Grupi i OE-ve nuk ka dorëzuar këtë listë të kontratave me informacionin e kërkuar. Kjo konfirmohet edhe nga arsyetimi i AK-së në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të ankesës së OE-së, ku AK thekson se "... nuk kemi kërkuar dokumente shtesë nga operatori sipas nenit 72 për listën e kontratave sepse nuk ka qenë në renditje për shpërblim dhe dokumente ne i kërkojmë vetëm për operatorin të cilin e shpërblejmë. Nëse operatori i renditur me numër 1 dështon, atëherë mund të kërkojmë dokumentin që mungon dhe lejon ligji."

AK në raportin e vlerësimit dhe njoftimin mbi vendimin e datës 19.10.2023 ka vlerësuar se Grupi i OE-ve plotëson kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, por oferta e tyre është renditur e dyta (2) sipas kritereve të dhëna. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe njoftimi i AK-së konstatojnë se Grupi i OE-ve plotëson kërkesat e përcaktuara, përfshirë edhe kërkesën për listën e kontratave, megjithëse nuk është dorëzuar dëshmia e kërkuar, lista e kontratave. Kështu, konstatimet e komisionit vlerësues dhe Zyrës së Prokurimit Publik janë në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit të Prokurimit Publik, ku theksohet "AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

Për më tepër, arsyetimi i AK-së se sqarimet shtesë konform nenit 72 të Ligjit të Prokurimit Publik kërkohen vetëm për OE që rekomandohen për kontratë nuk mbështetet në asnjë dispozitë të Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregullores së Prokurimit Publik. Arsyetimi paraqet vlerësimin kontradiktor të AK-së, ku në Raportin e vlerësimit dhe njoftimin mbi vendimin e AK-së konstatohet se plotësohen kërkesat e përzgjedhjes, ndërsa në vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim AK thekson se nuk janë kërkuar dëshmitë për shkak se GOE nuk janë rekomanduar për shpërblim me kontratë. Prandaj, pretendimi ankimor në këtë pikë ***është i bazuar.***

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Cacttus" Sh.a.,. Argumentimi në raportin e ekspertes shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertes shqyrtuese mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertes shqyrtuese janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Cacttus" Sh.a., i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertes shqyrtuese. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë faktet dhe rrethanat e paraqitura ne raportin e ekspertes. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i operatorit ekonomik ankues "Cacttus" Sh.a., janë të bazuara.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues/ teknik, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues/teknik i kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorëve ekonomik ankuesOE"Wire Labs Kosova" L.L.C., & OE "Cacttus" Sh.a., Argumentimi në raportin e eksperteve është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues/teknik mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues/teknik, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish. Paneli Shqyrtues, vlerëson se me kthimin e këtij aktiviteti të prokurimit në Rivlerësim AK do ti trajtoj të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, si dhe të veproj konform rekomandimeve te lartcekura ne harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues/teknik lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim.

- Konstatimet e panelit shqyrtues

Pavarësisht rekomandimeve, Paneli shqyrtues vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues/teknik, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues/teknik janë dhënë shpjegime profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje lidhur me pohimet ankimore.

Prandaj Paneli shqyrtues mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues/ teknik dhe vendos që AK gjatë fazës së ri-vlerësimit të veproj konform nenit 59 dhe 60 të LPP.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues/teknik lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP-së dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Sipas nenit 27 të LPP, sipas të cilit, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkese të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E EKONOMISË, MINISTRIA E EKONOMISË**
- OE - **" Cacttus " Sh.a., Wire Labs Kosova L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: